

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 Gusht 2010), dhe nenet 47, 48 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2019, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TRANSAKSIONET ME PERSONAT E NDËRLIDHUR ME BANKËN DHE PUNËTORËT E BANKËS

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj kufizimet monetare të cilat kontrollojnë ekspozimet e personave të ndërlidhur me bankën, ku konflikti i interesit mund të jetë i pranishëm dhe siguron që kreditimi i tillë të bëhet në baza të shëndosha dhe të paanshme, si dhe kufizimi i ekspozimeve ndaj të punësuarve të bankës.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat e licencuara nga BQK për të operuar në Republikën e Kosovës.
3. Për degët e bankave të huaja është i aplikueshëm vetëm Neni 6 i kësaj rregullore.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përcaktuara në Nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 për banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare (në vijim: *Ligji për Bankat*) dhe/ose siç përcaktohen në vijim për qëllimin e kësaj rregullore:
 - 1.1. **Bankë** - do të thotë një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur.
 - 1.2. **Degë e bankës së huaj** - do të thotë një person që është i organizuar, ka selinë e vet dhe posedon licence për tu angazhuar në veprimtari bankare në ndonjë juridiksion tjetër përveç Kosovës.

- 1.3. **Menaxher i Lartë** - nënkupton kryeshefin ekzekutiv, zyrtarin kryesor për financa, zyrtarin kryesor për operacioneve, zyrtarin kryesor për risk të bankës dhe çdo person, përveç drejtorit, i cili (i) i raporton drejtpërsëdrejti bordit ose merr pjesë ose ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të bankës, pavarësisht nëse ai person ka titull zyrtar apo merr kompensim për veprimet e tilla, dhe (ii) është caktuar si menaxher i lartë nga BQK-ja. Në rastin kur një bankë e huaj licencohet për të operuar me një ose më shumë degë në Kosovë, menaxheri i bankës kryesore në Kosovë dhe çdo menaxher tjetër apo zëvendës menaxher i një dege në Kosovë do të konsiderohet të jetë anëtar i menaxhmentit të lartë.
- 1.4. **Aksionar kryesor** - nënkupton personin që posedon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi, së bashku ose në bashkëveprim me persona tjerë, dhjetë përqind ose më tepër të çfarëdo klase të aksioneve me të drejtë vote të një banke ose kompanie apo dhjetë përqind të interesit në kapital në një bankë ose kompani.
- 1.5. **Punëtor** - nënkupton çdo person, përveç personave të ndërlidhur me bankën, siç përcaktohet me Nenin 3 të Ligjit, i cili mban pozitë punësimi në bankë dhe merr kompensim për shërbimet e kryera.
- 1.6. **Individë të ndërlidhur** - nënkuptohen bashkëshortja e një personi, fëmijët e një personi, qofshin të rritur ose të mitur, dhe pavarësisht nëse banojnë ose jo me atë person, nëna, babai, njerku, njerka, vëllezërit, vëllezërit nga babai ose nëna, motrat, motrat nga babai ose nëna, tezet, dajallarët, axhallarët, kushërinjtë e parë, qoftë nga gjaku ose martesë, ose ndonjë person tjetër me të cilin ekziston lidhja familjare;
- 1.7. **Kushërinjtë e parë** - janë njerëzit në familje, të cilët kanë njërin apo të dy gjyshërit të njëjtë (fëmijët e hallës/tezes dhe axhës/dajës). Këto lidhje gjithashtu referohen si lidhje gjaku të shkallës së dytë.
- 1.8. **Personat e ndërlidhur me bankën** - nënkupton çdo person që ka se paku njërin nga marrëdhëniet e mëposhtme:
- 1.8.1. Çdo Menaxher i Lartë apo Drejtor i bankës dhe çdo aksionar kryesor i bankës;
- 1.8.2. Çdo person i cili është i lidhur me Menaxherin e Lartë apo Drejtorin apo aksionarin kryesor të bankës, me martesë apo lidhje gjaku të shkallës së dytë;
- 1.8.3. Çdo entitet juridik, në të cilin Menaxheri i lartë apo Drejtori apo aksionari kryesor i bankës është gjithashtu aksionar kryesor;
- 1.8.4. Çdo person i cili ka interes të konsiderueshëm në një entitet juridik, në të cilën banka ka interes të konsiderueshëm;
- 1.8.5. Çdo subjekt i varur i bankës; dhe
- 1.8.6. Çdo person tjetër i përfshirë në marrëdhënie me bankën, të ngjashme me pikat e identifikuar më lart nga 1-5, që BQK-ja përcakton me rregullore apo urdhër të jetë person i ndërlidhur me bankën.

Neni 3

Transaksionet kreditore me personat e ndërlidhur

1. Transaksionet kreditore me personat e ndërlidhur duhet të bëhet në baza të shëndosha dhe të paanshme, duke i zbatuar parimet e mëposhtme:
 - 1.1. Aftësia e pagesës e palëve të ndërlidhura nuk është më e vogël se sa normalisht kërkohet nga personat e tjerë;
 - 1.2. Afatet dhe kushtet e transaksioneve kreditore me palët e ndërlidhura nuk duhet të jenë më të favorshme se sa ato me palët e tjera me rrethana dhe aftësi pagese të njëjtë, në lidhje me afatin, normën e interesit, planin e pagesës dhe kërkesat për mbulesë me kolateral/hipotekë;
 - 1.3. Menaxherët e lartë të bankave mund të aplikojnë për kredi për nevoja individuale, por jo edhe biznesore.
 - 1.4. Transaksioni kreditor duhet të jetë në interes të bankës.

Neni 4

Aprovimi dhe kontrolli nga bordi i drejtorëve

1. Për qëllime të Neneve 47 dhe 48 të Ligjit për Banka, Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për krijimin e politikave të qarta mbi transaksionet kreditore dhe menaxhimin e ekspozimeve kreditore me personat e ndërlidhur të bankës. Politika duhet të rishikohet në baza vjetore dhe çdo ndryshim i politikës duhet të aprovohet nga ana e Bordit të Drejtorëve.
2. Ekspozimet e lejuara nga banka për individët e ndërlidhur me bankën janë subjekt i aprovimit paraprak nga ana e Bordit të Drejtorëve të bankës, mbi kufizimin e përcaktuar minimal të ekspozimeve të mëdha, të përcaktuar nga BQK-ja.
3. Bordi i Drejtorëve duhet të siguroj se ekziston një mekanizëm adekuat për implementimin e politikave dhe procedurave lidhur me kontrollin dhe menaxhimin e ekspozimeve kreditore dhe rrezikut të keqpërdorimeve të lidhura me transaksionet me palë të ndërlidhura.
4. Bordi i Drejtorëve duhet të krijoj metoda të përshtatshme, të cilat lehtësojnë identifikimin me kohë të palëve të cilat janë të ndërlidhura. Metodatat tilla mund të përfshijnë deklarimet e drejtorëve, zyrtarëve kryesor dhe aksionarëve kontrollues të subjekteve të varura dhe të afërmit e tyre. Lista e palëve të ndërlidhura duhet të rifreskohet rregullisht.
5. Funkzioni i auditimit të brendshëm duhet të kryej rishikime të rregullta mbi transaksionet kreditore, administrimin dhe menaxhimin e ekspozimeve kreditore me palët e ndërlidhura, për të siguruar pajtueshmëri me politikatat dhe procedurat e bankës. Raporti i auditimit të brendshëm duhet t'i dërgohet Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit.
6. BQK-ja do të zbrit çdo huazim për personin e ndërlidhur me bankën për qëllimet e llogaritjes së nivelit të kapitalit rregullativ sipas Nenit 15 dhe 16 të Ligjit për Banka.

Neni 5

Kufizimi i ekspozimit për personat e ndërlidhur

1. Për qëllim të kësaj rregullore, ekspozimi kreditor përfshin që të dyja, shumën aktive dhe pjesën e pashfrytëzuar të huazimit, që rrjedh nga transaksioni kreditor me personat e ndërlidhur.
2. Asnjë bankë nuk duhet të ketë një ekspozim ndaj ose në dobi të një personi që ka lidhje me atë bankë, nëse si rezultat i kësaj, shumën e përgjithshme të ekspozimit ndaj ose në dobi të personave që kanë lidhje me atë bankë do të tejkalonte dhjetë për qind (10%) të kapitalit të klasit të I të bankës.
3. Asnjë bankë nuk duhet të jap kredi personave të lidhur ose kredi për përfitim të personave të lidhur, nëse si rezultat prej kësaj shumën e grumbulluar e papaguar e të gjitha kredive të dhëna nga banka personave të lidhur të bankës do të tejkalojë njëqind (100) për qind të kapitalit të bankës.

Neni 6

Ekspozimi për punëtorët

Asnjë bankë nuk duhet të japë mjete financiare për një punëtor/e të saj mbi shumën prej treqind mijë (300.000,00) euro.

Neni 7

Zbatimi, masat korigjuese dhe dënimet civile

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Bankat.

Neni 8

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja për Transaksionet me Personat e Ndërlidhur me Bankën dhe Punëtorët e Bankës, e aprovuar nga Bordi i BQK-së me 29 nëntor 2012, dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës